



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 42 datë 28.06.2024

**“PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET FONDACIONIT SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINE DHE BASHKISË SHKODËR PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “SUNNY SCHOOLS”, I CILI KA PËR QËLLIM INSTALIMIN E IMPIANTEVE FOTOVOLTAIKE (PRODHIM ENERGJIE ELEKTRIKE PËRMES ENERGJISË DIELLORE) NË SHKOLLAT E MESME “JORDAN MISJA”, “OSO KUKA”, “NIKOLLË ZAGORJANI” DHE SHKOLLAT 9 VJECARE “DËSHMORET E PRISHTINËS”, “EDITH DURHAM”, ”TRINGË SMAJLI” GRUDË, “DESHMORET RRENCIT”, SI EDHE DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E SAJ KRYETARIT TË BASHKISË”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 28.06.2024, me propozim të kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit Nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar, VKM Nr.510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial, si dhe relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë në parim marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet fondacionit shoqëria e hapur për Shqipëri dhe Bashkisë Shkodër, për zbatimin e projektit “Sunny Schools”, i cili ka për qëllim instalimin e impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore) në shkollat e mesme “Jordan Misja”, “Oso Kuka”, “Nikollë Zagorjani” dhe shkollat 9 vjeçare “Dëshmoret e Prishtinës”, “Edith Durham”, ”Tringë Smajli” Grudë, “Deshmoret Rrencit”, si edhe dhënie e autorizimit për nënshkrimin e saj kryetarit të bashkisë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkise.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR**

**Oltion LULI**



**Sekretare e Këshillit Bashkiak**

**Sabina DANAJ.**

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kundër 8

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 02.07.2024